

**NDËRLIDHJA NË MES TË MBËSHTETJES SOCIALE DHE ZHVILLIMIT TË  
AFTËSIVE SOCIAL-EMOCIONALE TEK ADOLESHENTËT**

**TEMA PËR TITULLIN MASTER NË PSIKOLOGJINË SHKOLLORE DHE  
KËSHILLIM**

**Nga kandidatja:**

**Venera Suka**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË**

**Prishtinë, 2024**

Qëllimi i këtij studimi është që të shihet ndërlidhja ndërmjet mbështetjes sociale dhe zhvillimi i aftësive social-emocionale tek adoleshentë. Gjithashtu qëllim i këtij studimi është që të shoh apo identifikoj nivelin e këtyre variablave në mesin e adoleshentëve. Ky studim ka pasur për qëllim që të realizohet në mënyrë profesionale dhe akademike duke i respektuar rregullat e citimit dhe referimit duke i saktësuar ato si dhe çështjet etike në hulumtim. Objektivat e studimit do të jenë që të identifikohet niveli i ndërlidhjes midis mbështetjes sociale dhe zhvillimi i aftësive social-emocionale tek adoleshentët. Gjithashtu objektiv tjetër ka qenë të shihet nëse ka dallime në këtë aspekt. Në aspektin teorik ky hulumtim ka shqyrtuar literaturë relevante.

Pikëpamja se zhvillimi social-emocional i fëmijëve ndikon në të gjithë jetën e tyre ka sjellë ndryshime në perspektivat ndaj fëmijëve vitet e fundit. Aftësitë social-emocionale mund të mësohen dhe zhvillohen në çdo moshë, por avantazhet janë më të mëdha nëse strategjitë e zhvillimit zbatohen në moshë të hershme (Irina-Mihaela & Olga, 2020). Aftësitë social-emocionale janë një koncept që përfshin njohuri, aftësi dhe qëndrime për të identifikuar dhe menaxhuar emocionet, për t'u kujdesur për të tjerët, të veprojnë në mënyrë etike dhe të përgjegjshme për të marrë vendime të mira, për të zhvilluar marrëdhënie pozitive dhe për të shmangur sjelljen negative (Elias & Mocer, 2012). Hulumtimi përqipet që t'iu përgjigjet pyetjeve kërkimore si: P1. Çfarë është ndërlidhja midis mbështetjes sociale dhe kompetencave social-emocionale tek adoleshentët? P2. A ekzistojnë dallime gjinore për mbështetjen sociale të adoleshentët? P3. A ekzistojnë dallime gjinore në zhvillimin social-emocional? P4. Cili është niveli i ndërlidhjes në mes të kompetencave social-emocionale?

Kompetenca social-emocionale është një qëllim i rëndësishëm dhe i denjë për zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve duke pasur parasysh lidhjen e saj të vendosur me rezultate pozitive afatshkurtra dhe afatgjata (Eisenberg, Spinrad & Knafo-Noam, 2015 ).

Mbështetja sociale është një koncept shumëdimensional që mund të përkufizohet si "ndihma - furnizimi i burimeve të prekshme ose jo-materiale - që individët përfitojnë nga anëtarët e tyre të rrjetit". Në përgjithësi, studimet tregojnë se mbështetja sociale aktuale dhe e perceptuar ndikon pozitivisht në shëndetin mendor (Song et al., 2011).

Hipotezat: 1. “Ekziston ndërlidhje në mes mbështetjes sociale dhe kompetencave social-emocionale tek adoleshentët”; 2. “Ekzistojnë dallime gjinore për mbështetjen sociale të adoleshentët”; 3. “Ekzistojnë dallime gjinore në zhvillimin social-emocional të adoleshentëve”; 4. “Kompetencat social-emocionale korrelojnë pozitivisht njëra me tjetrën”.

Ky studim është i llojit kuantitativ me dizajn deskriptiv-korrelacional. Për nga dimensionin kohor studimi është ndër-seksional cili është projektuar për të përcaktuar nëse dy apo më shumë variabla janë të lidhura njëra me tjetrën. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrëseve të cilët janë përfshirë në këtë studim është 150 subjekt. Përzgjedhja e mostrës është bërë në mënyrë të qëllimshme pasi që fokusi dhe orientimi i hulumtimit ka qenë tek adoleshentët si konstrukt mostrimi për të nxjerr rezultate lidhur më supozimet e ngritura.

Prandaj ky punim është ideuar, specifikuar dhe organizuar për të matur nivelin e ndërlidhjes në mes të këtyre variablave si dhe identifikimin e dallimeve gjinore. Studimi është i drejtuar apo i udhëhequr nga katër hipoteza, dy krahasuese dhe dy të tjera korrealacionale të cilat do të paraqitën, krahasohen dhe analizohen në vazhdim.

Për ta testuar hipotezën e parë të këtij studimi: *“Ekziston ndërlidhje në mes mbështetjes sociale dhe kompetencave social-emocionale tek adoleshentët”*, është bërë analiza e korrelacionit ku është raportuar lidhshmëri pozitive dhe signifikante në mes të mbështetjes sociale dhe

kompetencave social-emocionale. Këto rezultate janë të rëndësishme dhe mbështesin këtë hipotezë.

Kompetenca social-emocionale është një qëllim i rëndësishëm dhe i denjë për zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve duke pasur parasysh lidhjen e saj të vendosur me rezultate pozitive afatshkurtra dhe afatgjata. Pavarësisht thjeshtësisë në dukje të vetë konceptit, historikisht, ka pasur pak konsensus për përcaktimin dhe konceptimin e kompetencës sociale dhe emocionale (Eisenberg, Spinrad, & Knafo-Noam, 2015; Goodman, Joshi, Nasim, & Tyler, 2015).

Këto të gjetura dhe konstatime teorike janë në përputhje më të rezultatet e hulumtimit tonë ku mbështetja sociale dhe kompetencat social-emocionale kanë treguar lidhshmëri pozitive në mes vete. Rezultatet janë në harmoni si me aspektin teorik, po ashtu edhe atë hulumtues. Kjo do të thotë se sa më e madhe që të jetë mbështetja sociale ajo ndikon pozitivisht në zhvillimin e kompetencave sociale tek adoleshentet.

Për ta testuar hipotezën e dytë të këtij studimi: *“Ekzistojnë dallime gjinore për mbështetjen sociale të adoleshentët”*, është bërë analiza e t-testit ku femrat raportuan mesatare ( $M=37.31$ ) dhe meshkujt ( $M=29.82$ ) dhe [ $t= 5.374$ ,  $p<. 000$ ], ky rezultat është i rëndësishëm dhe e mbështet këtë hipotezë.

Gjinia luan një rol në mbështetjen sociale. Sipas Sharir, Tanasescu, Turbow dhe Maman (2007), të cilët studiuuan cilësinë e jetës në pacientët psikiatrikë, femrat kanë më shumë gjasa të marrin mbështetje sociale nga miqtë dhe të tjerët të rëndësishëm, sesa meshkujt. Për shembull, femrat marrin vizita më të shpeshta dhe më të gjata nga miqtë e tyre sesa meshkujt. Vizitat më të gjata mund të jenë tregues për pacientët e sasisë së kujdesit dhe mbështetjes që miqtë po ofrojnë.

Përveç kësaj, gjatë vizitave më të gjata, mund të shkëmbehen më shumë fjalë, ndjenja dhe mendime, duke e bërë të gjithë vizitën më domethënëse për femrat.

Për ta testuar hipotezën e tretë të këtij studimi: *“Ekzistojnë dallime gjinore në zhvillimin social-emocional të adoleshentëve”*, është bërë analiza e t-testit për variablat e kompetencave sociale:

Vetëdija: femrat (M=17.60), meshkujt (M=16.06) dhe [t= 3.770, p<. 000], Ndërgjegjësimi social: femrat (M=17.82), meshkujt (M=15.27) dhe [t= 3.737, p<. 000], Vetë menaxhimi: femrat (M=20.81), meshkujt (M=19.23) dhe [t= 2.087, p<. 039], Menaxhimi i marrëdhënieve: femrat (M=16.91), meshkujt (M=15.21) dhe [t= 2.267, p<. 025], Vendimmarrja e përgjegjshme: femrat (M=16.86), meshkujt (M=14.40) dhe [t= 3.207, p<. 002]. Këto rezultate janë të rëndësishme dhe mbështesin këtë hipotezë.

Ne jemi të interesuar kryesisht për dallimet gjinore në zhvillimin e aftësive socio-emocionale në këto vende. Të kuptuarit e rolit të gjinisë është kritike për të kuptuar se si kultura formon zhvillimin e aftësive socio-emocionale. Kontekstet kulturore mund të ndikojnë në mënyrën se si fëmijët dhe të rriturit meshkuj dhe femra shfaqin dhe kontrollojnë sjelljet e tyre sociale (Hervé et al. 2022). Të gjeturat nga hulumtimi jonë janë në përputhje me të gjeturat dhe konstatimet teorike të hulumtimeve të lartë cituara.

Për ta testuar hipotezën e katërt të këtij studimi: *“Kompetencat social-emocionale korrelojnë pozitivisht njëra me tjetrën”*, është bërë analiza e korrelacionit ku është raportuar lidhshmëri pozitive dhe signifikante në mes të mbështetjes sociale dhe kompetencave social-emocionale. Këto rezultate janë të rëndësishme dhe mbështesin këtë hipotezë. Aftësitë socio-emocionale janë procese të cilat fëmijët dhe të rriturit fitojnë dhe zbatojnë kompetencat thelbësore për të njohur dhe menaxhuar emocionet, për të vendosur dhe arritur qëllime pozitive.